**Informacioni parakontraktor**

INFORMACIONI I STANDARDIZUAR PARAKONTRAKTOR I KREDISË KONSUMATORE
ANEKS NR. 1

**Emri dhe detajet e kontaktit të bankës**

| | |
|---|---|
| Banka | **Raiffeisen Bank Sh.a** |
| Adresa | **"Rruga e Kavajes", Tirane, Shqiperi** |
| Numri i telefonit (*) | **+355 2 222 669; Call Center +355 4 2 274 910** |
| Adresa e postës elektronike (*) Numri i faksit (*) | **info@raiffeisen.al, ankesa.online@raiffeisen.al, sugjerime@raiffeisen.al** |
| Adresa e web-it | **https://www.raiffeisen.al** |

*(*) Ky informacion është opsional për Bankën*

**Përshkrimi i karakteristikave kryesore të produkteve të kredisë**

| | |
|---|---|
| Teksti prezantues | Ky dokument nuk përbën një ofertë ligjore detyruese. Shifrat janë dhënë në mirëbesim dhe janë një prezantim i saktë i ofertës që banka do të bëjë sipas kushteve aktuale të tregut, bazuar në informacionin e dhënë. Megjithëkëtë, këto shifra mund të luhaten sipas kushteve të tregut. Dhënia e këtij informacioni nuk parasheh detyrimin e kësaj të fundit për të akorduar kredi. |
| Lloji i kredisë | Kredia Personale e pasiguruar u jepet individëve me pagë të verifikueshme apo të ardhura nga biznesi personal (PF) për përdorim të gjerë personal (jo për qëllime biznesi) dhe bazuar në cilësinë dhe aftesinë e huamarrësit (bashkëhuamarrësve) për të ripaguar kredinë. |

Kanalet e shitjes digjitale / deget e bankes

| Kanali i Aplikimit | Aplikimet ne kanalin digjital | | | Aplikimet ne deget e bankes | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Segmenti i Klientit | Kliente pagamarres Individë | Kliente pagamarres Premium | Kliente jo-pagamarres | Kliente pagamarres Individë | Kliente pagamarres Premium | Kliente jo-pagamarres | Kliente te vetepunesuar |
| Shuma maksimale | 3 milion leke | 3 milion leke | 1 milion leke | 3 milion leke | 3 milion leke | 2.5 milion leke | 1.5 milion leke |
| Afati maksimal | 10 vite | 10 vite | 7 vite | 10 vite | 10 vite | 10 vite | 7 vite |

| | |
|---|---|
| Vlera totale e kredisë dhe monedha ( *Nënkupton shumën totale* | Monedha: LEK / EUR*<br><br>Shuma maksimale e kredisë përcaktohet në bazë të segmentit të klientit, kanalit të aplikimit dhe vlerësimit të rrezikut të klientit sipas përcaktimeve më poshtë: |

*të disponueshme, të kredisë )*

| **Kanali i Aplikimit** | **Shuma e Kredise Personale ne Rrjetin e degeve RBAL** | |
|---|---|---|
| Segmenti i Klientit | **Klientë pagamarrës në RBAL:** | **Kliente jo-pagamarrës në RBAL:** |
| Segmenti Premium (PRM) | Kliente ekzistues / te rinj rrezik minimal & rrezik i mesem**:<br>100,000 LEK/ 1,000 EUR - 3,000,000 LEK / 30,000 EUR<br><br>Kliente ekzistues / te rinj rrezik i pranueshem**:<br>100,000 LEK / 1,000 EUR - 2,500,000 LEK/ 25,000 EUR | Kliente ekzistues rrezik minimal **:<br>100,000 LEK / 1,000 EUR - 3,000,000 LEK/22,500 EUR<br>Kliente ekzistues rrezik i mesem & rrezik i pranueshem**:<br>100,000 LEK / 1,000 EUR - 2,500,000 LEK/19,000 EUR<br><br>Kliente te rinj rrezik minimal **:<br>100,000 LEK / 1,000 EUR - 2,500,000 LEK/19,000 EUR<br>Kliente te rinj rrezik i mesem & rrezik i pranueshem**:<br>100,000 LEK / 1,000 EUR - 2,000,000 LEK/ 15,000 EUR |
| Segmenti Individë (MASS) | Kliente ekzistues / te rinj rrezik minimal*: 100,000- 3,000,000 LEK<br>Kliente ekzistues / te rinj rrezik i mesem*: 100,000-2,500,000 LEK<br>Kliente ekzistues / te rinj rrezik i pranueshem*: 100,000-2,000,000 LEK | Kliente ekzistues rrezik minimal*: 100,000-2,500,000 LEK<br>Kliente ekzistues rrezik i mesem*: 100,000-2,000,000 LEK<br>Kliente ekzistues rrezik i pranueshem*: 100,000-1,500,000 LEK<br><br>Kliente te rinj rrezik minimal*: 100,000-2,000,000 LEK<br>Kliente te rinj rrezik i mesem & rrezik i pranueshem*: 100,000-1,500,000 LEK |
| Kliente te vetepunesuar (PF) | Kliente ekzistues / te rinj: 100,000 LEK / 1,000 EUR - 1,500,000 LEK / 15,000 EUR | |
| **Kanali i Aplikimit** | **Shuma e Kredise Personale ne Kanalet Online** | |
| Segmenti i Klientit | **Kliente pagamarrës në RBAL:** | **Kliente jo-pagamarrës në RBAL:** |
| Segmenti Premium (PRM): | Kliente ekzistues / te rinj rrezik minimal & rrezik i mesem**:<br>100,000 LEK - 3,000,000 LEK<br><br>Kliente ekzistues / te rinj rrezik i pranueshem**:<br>100,000 LEK - 2,500,000 LEK | Kliente ekzistues / te rinj: 100,000- 1,000,000 LEK |
| Segmenti Individë (MASS) | Klientë ekzistues / të rinj rrezik minimal*: 100,000- 3,000,000 LEK<br>Klientë ekzistues / të rinj rrezik i mesëm*: 100,000-2,500,000 LEK<br>Klientë ekzistues / të rinj rrezik i pranueshëm*: 100,000-2,000,000 LEK | Kliente ekzistues / te rinj: 100,000- 1,000,000 LEK |

*Kredia personale ofrohet në euro vetëm në Rrjetin e degëve RBAL dhe vetëm për klientët premium që e marrin pagën në monedhën euro.

**Perllogaritja e pikesimit (e cila percakton rrezikun e ulet apo te pranueshem ) bazohet mbi te dhenat e klientit: socio-demografike,financiare, marredhenia e klientit me banken dhe korrektesia e tij ne shlyerjen detyrimeve ndaj subjekteve kreditore. Referuar ne keto kritere dhe bazuar ne analizen financiare do te percaktohet shuma dhe afati i kredise. Klientët që paraqesin rrezik minimal kanë nivel pikësimi 0.5-2.5, klientët që paraqesin rrezik të mesëm kanë nivel pikësimi 3, ndërsa klientët që paraqesin rrezik të pranueshëm kanë nivel pikësimi 3.5 deri ne 4.0.

<table>
<tr><td>Nëse është e aplikueshme Kredia është në monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat.</td><td colspan="3">Në monedhë të ndryshme nga të ardhurat e klientit<br>Në të njëjtën monedhë me të ardhurat e klientit</td></tr>
<tr><td>Nëse është e aplikueshme Vlera e këstit të kredisë, e shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, mund të ndryshojë.</td><td colspan="3">Ju do të merrni një njoftim në rastet kur, si rezultat i ndryshimit të kursit të këmbimit, kësti i kredisë [i shprehur në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat (p.sh. kesti eshte 33,474.84 Lek) ] tejkalon vlerën [shtoni shumën në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, e cila është pothuaj 20% më e lartë se kundërvlera e këstit që do të rezultonte nëse do të aplikohej kursi i këmbimit midis monedhës së kredisë dhe monedhës në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në datën e nënshkrimit të kontratës (p.sh. 40,169.81 Lek)].<br>Ju do të keni mundësinë të konvertoni monedhën e kredisë në [monedhën në të cilën gjeneroni të ardhurat],nëse plotësohen kushtet në fuqi të bankës si:<br><br>• Të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar këstin e kredisë në monedhën e konvertuar<br>• Kursi i këmbimit me të cilin do të realizohet konvertimi i monedhës së kredisë, do të jetë kursi zyrtar i bankës në ditën që kryhet konvertimi<br>• Kushte të tjera në varësi të tipit të produktit dhe rasteve specifike<br><br>(Nëse është e aplikueshme) Ju do të keni mundësinë të përdorni [shtoni llojet e instrumenteve financiare që banka i ofron konsumatorit për t'u mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit] dhe [kushtet]. N/A</td></tr>
<tr><td>Kushtet që rregullojnë tërheqjen e fondeve (Nënkupton si dhe kur do merren paratë)</td><td colspan="3">Si kusht për lëvrimin e kredisë, Kredimarrësi do të hapë një llogari rrjedhëse pranë Bankës Raiffeisen, e quajtur "llogaria e kredisë", në të cilën Banka do të bëjë disbursimin e fondeve dhe nëpërmjet së cilës do të behet ripagimi i kredisë.<br>Mbas disbursimit te kesaj kredie klientit i kalojne fondet ne llogarine rrjedhese, dhe mund ti terheqe nepermjet sporteleve te Bankes,me mjete elektronike ose me karte debiti.</td></tr>
<tr><td>Kohëzgjatja e kontratës së kredisë</td><td>Afati i Kredise Personale ne Rrjetin e degeve RBAL<br><br>Klientë pagamarrës në RBAL:<br>Kliente ekzistues / te rinj: 6 muaj - 120 muaj<br><br>Klientë pagamarrës në banka të tjera:<br>Kliente ekzistues: 6 muaj - 120 muaj<br>Kliente te rinj: 6 muaj - 84 muaj<br><br>Kliente te vetepunesuar (PF):<br>Kliente ekzistues / te rinj: 6 muaj - 84 muaj</td><td colspan="2">Afati i Kredise Personale ne Kanalet Online<br><br>Klientë pagamarrës në RBAL:<br>Kliente ekzistues / te rinj: 6 muaj - 120 muaj<br><br>Klientë pagamarrës në banka të tjera:<br>Klientë ekzistues/ te rinj: 6 muaj - 84 muaj</td></tr>
<tr><td rowspan="6">Këstet dhe, kur është e mundur, mënyra se si do të shlyhen këstet</td><td>Shuma e Kredisë</td><td>700,000.00</td><td>LEK</td></tr>
<tr><td>Totali i Interesave</td><td>187,231.61</td><td>LEK</td></tr>
<tr><td>Numri i pagesave mujore</td><td colspan="2">84 Muaj</td></tr>
<tr><td>Komisioni i Administrimit</td><td>14,000.00</td><td>LEK</td></tr>
<tr><td>Komisioni i Sigurimit</td><td>17,500.00</td><td>LEK</td></tr>
<tr><td>Norma e Interesit Promocional:</td><td colspan="2">7.5% per 3 vitet e para te kredise</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | Norma e Interesit pas periudhes promocionale: | Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore + 8.4% = 10.965% |
| | Shlyerja e kredisë do të kryhet me këste mujore (që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin) në datën e rënë dakort midis palëve sipas planit të amortizimit të kredisë. | |
| Shuma totale që konsumatori do të ketë për të paguar ( *Nënkupton shumën e fondeve të mundshme për t'u marrë hua, plus interesat dhe kostot e mundshme që lidhen me kredinë* ) | Shuma totale që klienti do të paguajë për një kredi me shumën 700,000.00LEK duke përfshirë të gjitha kostot për përfitimin e kësaj kredie është: 887,231.61 LEK<br><br>Shuma totale që klienti do të paguajë për kredinë e kërkuar (kryegjë + interes) është llogaritur me normën e mësipërme të interesit. Kjo shumë totale mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve të Interesi i Bonove te Thesari 12-mujore dhe minimumit të interesit të aplikuar për kredinë e kërkuar. | |
| | Shembull: Shuma e kredisë 1,000,000 lekë; Afat kredie 10 vite; Interesi 7.5% për 3 vitet e para me NEI = 8.13%. Kësti i kredisë për 3 vitet e para është 11,870.18 lekë për t'u paguar çdo muaj (përfshin kryegjë + interes)<br><br>Nëse klienti merr pagën në Bankën Raiffeisen, pas 3 viteve të para interesi do të jetë Bono Thesari 12-mujore e ndryshueshme çdo vit + 8.4%<br><br>Nëse supozojmë se vlera e Bonos së Thesarit do të jetë sa është aktualisht, atëherë interesi për kredinë do të jetë: 2.565% + 8.4% = 10.965%  Kësti i kredisë llogaritur me këtë interes, për vitet në vijim do të jetë 13,236.69 lekë.<br><br>Shuma totale e pagueshme për kredinë në vlerë 1,000,000 Lekë është 1,466,575.47 Lekë. Kjo shumë totale mund të ndryshojë në varësi të ndryshimeve të Interesi i Bonove te Thesari 12-mujore dhe minimumit të interesit të aplikuar për kredinë e kërkuar. | |
| Nëse është e aplikueshme Garanci/siguri të nevojshme | Nuk kërkohet kolateral | |

**Kostoja e kredisë**

| | |
|---|---|
| Norma e interesit të kredisë që do të aplikohet në kontratën e kredisë | Raiffeisen BANK sh.a., e percakton normën e interesit të kredisë suaj bazuar tek Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore/Euribor (1-vjecar) për Kreditë në ALL/EUR plus një përqindje fikse për gjithë periudhën e kredisë Për cdo vit pasardhës të kredisë, do të rishikohet norma e interesit baze të Interesi i Bonove te Thesarit 12 mujore/Euribor 1-vjecar të publikuar nga Banka për vitin kalendarik, kur paguhet kësti i 12-të.<br><br>Në rast se kredia është me kushte promocionale me normë interesi fikse për një periudhë të caktuar, përllogaritja e késteve për periudhën në vijim do të fillojë menjëherë pas përfundimit të afatit të periudhës fikse në datën e fillimit të interesit variabël. I njëjti proces përllogaritjeje do të përsëritet në periudha të njëjta deri në datën e maturimit të kredisë.<br><br>Interes i Bonove te Thesarit/Yield mesatar i ponderuar është norma e titujve te Qeverisë Shqiptare me afat 12 mujor, që rezulton nga ankandi i fundit organizuar nga Banka e Shqipërisë, si ndërmjetëse për shitjen e letrave me vlerë të Qeverisë Shqiptare. Rezultatet nga ankandet e bonove shpallen në të njëjtën ditë të organizimit të ankandit dhe publikohen në faqet respektive të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqiperisë.<br>Në rastet kur Norma Bazë e interesit ka vlerë negative, banka në kalkulimin e interesit do ta konsiderojë me vlerë 0.<br><br>EURIBOR është Norma e Interesit Ndërbankar për EURO-n. Kjo normë llogaritet nga Federata Bankare Europiane (FBE) dhe publikohet cdo ditë biznesi në orën 11(ora belge)<br><br>Normat e Euribor ndryshojnë cdo ditë pune bankare dhe mund t'i gjeni të publikuar edhe në sportelet e RBAL. Interesi i Bonove te Thesari 12-mujore rezulton nga ankandet e zhvilluara, rezultatet e te cilave shpallen ne të njëjtën ditë të organizimit të ankandit dhe publikohen ne faqet respektive te Ministrise se Financave dhe Bankes se Shqiperise<br><br>Në rast se Kredimarrësit nuk bien dakort me ndryshimin e normës së interesit sipas nenit të mësipërm, ata janë |

<table>
<tr><td rowspan="6"></td><td colspan="2">të detyruar të informojnë menjëherë mospranimin e këtij ndryshimi. Në këtë rast Kredimarrësit detyrohen të kryejnë ripagimin e plotë të shumës së mbetur të kredisë, duke paguar penalitetin përkatës që aplikohet në rastet e parapagimit</td></tr>
<tr><td colspan="2">Norma e interesit për kredinë e interesuar do të ofrohet në bazë të vlerësimit të rrezikut të klientit** sipas përcaktimeve më poshtë:</td></tr>
<tr><td colspan="2">Norma e interesit të Kredisë Personale në Rrjetin e degëve RBAL</td></tr>
<tr><td>Klientë pagamarrës në RBAL:<br><br>Monedha LEK:<br>Klientë rrezik minimal**:<br>Interesi i Bonove të Thesarit 12M + 8.15% (Min 7.5%)<br>Klientë rrezik i mesëm**:<br>Interesi i Bonove të Thesarit 12M + 8.40% (Min 7.5%)<br>Klientë rrezik i pranueshëm**:<br>Interesi i Bonove të Thesarit 12M + 8.65% (Min 7.5%)<br>Monedha EUR*:<br>Klientë rrezik minimal**: EURIBOR + 7.25% (Min 7.5%)<br>Klientë rrezik i mesëm**: EURIBOR + 7.50% (Min 7.5%)<br>Klientë rrezik i pranueshëm**: EURIBOR + 7.75% (Min 7.5%)</td><td>Klientë pagamarrës në banka të tjera:<br><br>Monedha LEK:<br>Interesi i Bonove të Thesarit 12M + 8.40% (Min 7.5%)<br><br>Monedha EUR*:<br>EURIBOR + 7% (Min 7.50%)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Norma e interesit për Kredinë Personale në kanalet Online per klientë pagamarrës në RBAL apo në banka të tjera: Monedha LEK:<br><br>Norma e interesit promocional:<br>Per aplikimet online te filluara dhe perfunduara jashte orarit zyrtar 7.5% fiks për 3 vite dhe me pas interesi standart sipas segmentit të klientit. Per aplikimet online te filluara dhe perfunduara gjate orarit zyrtar 9% fiks për 3 vite dhe me pas interesi standart sipas segmentit të klientit.<br><br>Norma e interesit standart (jo-promocional): Interesi i Bonove të Thesarit 12M + 8.40% (Min 7.5%)</td></tr>
<tr><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td rowspan="3">Norma efektive e interesit (NEI)<br><br>Është totali i kostos së kredisë për klientin, e shprehur si përqindje vjetore e vlerës së kredisë së dhënë dhe e llogaritur në përputhje me nenin 6 dhe aneksin nr. 1 të rregullores nr. 59 “Mbi transparencën për produktet dhe shërbimet bankare e financiare”</td><td colspan="2">NEI është norma e interesit që përfshin të gjitha kostot e kredisë për të cilën klienti po aplikon.<br><br>Totali i kostos së kredisë për klientin është totali i të gjitha shpenzimeve ku përfshihen interesat, komisionet dhe cdo lloj tjetër shpenzimi që klienti paguan për kredinë sipas kushteve të marrëveshjes së kredisë. Klienti do të informohet për vlerën e përafërt të NEI në momentin e aplikimit në planin e ripagimit paraprak dhe si aneks i kontratës së kredisë. Vlera e saktë e NEI-t do të jepet në planin e amortizimit pas disbursimit të kredisë të cilin klienti mund ta marrë duke u paraqitur në bankë ose nëpërmjet platformës digjitale Raiffeisen ON.</td></tr>
<tr><td>Norma Efektive e Interesit për kredinë e interesuar është 8.88%</td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">Shembull: NEI është 8.13% për kredinë me kushtet specifikuar më poshtë: Shuma 1,000,000 LEK; Numri i pagesave mujore 120; Komisioni i administrimit i cili do të paguhet njëherë = 20,000 LEK ; Komisioni i sigurimit PPI i cili do të paguhet njëherë 25,000 LEK, Interesi: 7.5% për 3 vitet e para, me pas 10.965% = 8.4%+ Interesi i Bonove te Thesarit 2.565%</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| A është e mundur të përfitohet kredia sipas kushteve të punës në të cilat tregtohet, duke përjashtuar:<br>-kontratat e sigurimit për kredinë?<br>*Nëse kostot e këtyre shërbimeve nuk njihen nga banka, ato nuk do të përfshihen në NEI .* | Kredia nuk mund të përfitohet pa kryer pagesën sigurimit të kredisë (PPI).<br>Kjo kosto është e përfshirë në përllogaritjen e NEI. |
| Kosto të tjera të lidhura me kredinë<br>*Nëse është e aplikueshme*<br>Mbajtja e një ose më shumë llogarive është e kërkuar për të regjistruar si transaksionet e pagesave ashtu edhe tërheqjet apo transferimet e fondeve nga njëra llogari në tjetrën. | Nuk aplikohet asnjë kosto tjetër e lidhur me kredinë. |
| Çdo kosto shtesë që është e detyrueshme për përfitimin e kredisë<br>*Kosto shtesë të pakthyeshme në rastin që aplikohen për marrjen e kredisë, të tilla si: komisioni i aplikimit, komisioni i angazhimit, komisioni i disbursimit etj.* | Ka 2 komisione që mbahen në disbursimin e kredisë:<br>- Komisioni i sigurimit të jetës për kredinë (PPI). Ky komision përbëhet nga dy paketa:<br>Paketa Standart 2.5% të shumës së kredisë<br>Paketa Ekstra 3.5% të shumës së kredisë<br><br>-Komisioni i administrimit të kredisë. Ky komision është 2.00% e shumës së kredisë që do të merret, minimumi 3,000 LEK dhe maksimumi 20,000LEK<br><br>Këto kosto janë të përfshira në përllogaritjen e NEI. |
| Plani i shlyerjes së kredisë | Kjo është një tabelë ilustruese për përllogaritjen e kësteve për 12 muajt e parë të kredisë.<br>Përllogaritja e kësteve për periudhën në vijim do të fillojë në ditën pasardhëse të punës pas datës së pagesës së këstit të 12-t***, me interesin e rishikuar sipas normës së interesit bazë të Interesi i Bonove të Thesarit 12-mujore më të fundit të publikuar nga Banka e Shqiperisë në datën e pagesës së këstit të 12-t***, për çdo vit pasardhës të kredisë dhe mbaron me plotësimin e një periudhe të re 12 mujore.<br><br>****Në rast se kredia është me kushte promocionale me normë interesi fikse për një periudhë të caktuar, përllogaritja e kësteve për periudhën në vijim do të fillojë menjëherë pas përfundimit të afatit të periudhës fikse në datën e fillimit të interesit variabël. I njëjti proces përllogaritjeje do të përsëritet në periudha të njëjta deri në datën e maturimit të kredisë.* |

| | |
|---|---|
| | **Plani i Amortizimit Paraprak**<br><br>Shuma e Kredise: 100,000.00<br>NEI: 10.72 %<br>Afati (ne Vite): 7.00<br>Interesi Baze: 9.00%<br><br>Data e Aplikimit: 01/06/2026<br>Numri i Kesteve: 84<br>Kesti Mujor: 1,608.91<br>Data e Pageses se Kestit: 01/07/2026<br>Data e Maturimit: 01/06/2033 |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Shuma e kostove për përdorim të caktuar të një pagese (p.sh. një kartë krediti) | Nuk aplikohen kosto të tilla |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Ndonjë kosto tjetër që rrjedh nga kontrata e kredisë | Nuk ka kosto te tjera. |
| *Nëse është e aplikueshme*<br>Kushtet, sipas të cilave kostot e sipërpërmendura që kanë të bëjnë me kontratën e kredisë mund të ndryshojnë | Nëse është e aplikueshme, Banka ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit të shkaktuar bashkë me fitimin e munguar, për shkak të vonesës në pagimin e detyrimit nga kredimarrësi, edhe në rastet kur për faj të këtij të fundit bëhet i pamundur ekzekutimi i detyrimit nga kredimarrësi. |
| *Nëse është e aplikueshme* | Klienti nuk ka asnjë detyrim për shpenzime noteriale. |

| Nr. | Data | Kesti | Interesi | Principali | Balanca |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 01/07/2026 | 1,608.91 | 750.00 | 858.91 | 99,141.09 |
| 2 | 01/08/2026 | 1,608.91 | 743.56 | 865.35 | 98,275.74 |
| 3 | 01/09/2026 | 1,608.91 | 737.07 | 871.84 | 97,403.90 |
| 4 | 01/10/2026 | 1,608.91 | 730.53 | 878.38 | 96,525.52 |
| 5 | 01/11/2026 | 1,608.91 | 723.94 | 884.97 | 95,640.55 |
| 6 | 01/12/2026 | 1,608.91 | 717.30 | 891.61 | 94,748.94 |
| 7 | 01/01/2027 | 1,608.91 | 710.62 | 898.29 | 93,850.65 |
| 8 | 01/02/2027 | 1,608.91 | 703.88 | 905.03 | 92,945.62 |
| 9 | 01/03/2027 | 1,608.91 | 697.09 | 911.82 | 92,033.80 |
| 10 | 01/04/2027 | 1,608.91 | 690.25 | 918.66 | 91,115.14 |
| 11 | 01/05/2027 | 1,608.91 | 683.36 | 925.55 | 90,189.59 |
| 12 | 01/06/2027 | 1,608.91 | 676.42 | 932.49 | 89,257.10 |

| | |
|---|---|
| Detyrimi për të paguar shpenzimet noteriale. | |
| Kostot në rastin e pagesave me vonesë<br>*Mungesa e pagesave të kësteve mund të sjellin pasoja të rënda për konsumatorin dhe e bëjnë procesin e mbajtjes së kredisë më të vështirë.* | Në rast se Kredimarrësi nuk paguan në kohë këstin e kredisë, Banka përvec normës së interesit, ka të drejtë të aplikojë penalitet në masën 20 % në vit, i llogaritur mbi detyrimin e këstit/kësteve të rradhes të pa paguar (që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë + interesin) për numrin e ditëve në të cilën ai është me vonesë. Përllogaritja e penalitetit: P= K*p*n/360<br>Ku:<br>P = Penaliteti<br>K = Kesti i rradhes<br>p = % e penalitetit per vonese<br>n = Nr i diteve ne vonese<br><br>*Shembull*: Kesti i rradhes eshte 10,500 leke Dite ne vonese 5 dite Penaliteti i paguar = 10,500*20%*5/360 = 29 leke<br>I njejti shembull mund te perdoret per te gjitha monedhat<br><br>Penalitetet dhe kamatëvonesat, të cilat paguhen nga kredimarrësi, nuk do te tejkalojnë në asnjë rast më shumë se 30% të shumës së detyrimit kontraktor (këstit/kësteve të papaguar të kredisë, që në çdo rast përfshijnë vetëm kryegjënë dhe interesin). |
| **Aspekte të tjera të rëndësishme ligjore** | |
| E drejta për t'u tërhequr | Klienti ka te drejtë të tërhiqet nga kontrata e kredisë pa ndonjë arsye, brenda 14 ditëve nga nënshkrimi i kontrates së kredisë, vetëm në rastet kur klienti, pas plotesimit të kërkesës me shkrim, paguan të plotë shumën e kredisë së përfituar plus interesat e përllogaritura për ditët përkatese. |
| Shlyerja (pagesa) e kredisë para afatit të maturimit<br>*Konsumatori ka të drejtë të kryejë në çdo kohë, paraafatit të maturimit, shlyerjen e pjesshme ose të plotë të kredisë.* | Klienti mund të bëjë shlyerje të parakohshme të kredisë në total ose pjesërisht (jo më pak se vlera e një kësti kredie) para afatit të përcaktuar në kontratë me kusht që të ketë paguar më parë të gjitha interesat e përllogaritura deri në momentin e shlyerjes. Shlyerja e pjesshme e kredisë do të bëhet në datën pasardhëse të këstit të rradhës. Në këtë rast, banka aplikon penalitet e komisioneve për shlyerje të parakohshme si më poshtë.<br><br>Komisioni për ripagim kur norma e interesit është variabël është 0%.<br><br>Komisioni për ripagim kur norma e interesit është fikse:<br>1% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja e kredisë bëhet para vitit të fundit të periudhës fikse.<br>0.5% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja bëhet gjatë vitit të fundit të periudhës fikse.<br>0% mbi principalin që do të shlyhet para afatit, nëse shlyerja bëhet gjatë periudhës variable të kredisë. |
| Mundësia e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit). | [Vendosni kushtet e zëvendësimit të sendit/pasurisë (kolateralit)]<br>N/A |
| *Nëse është e aplikueshme*<br><br>Produkte/shërbime shtesë:<br>*(Ky informacion është opsional për bankën)*<br>Çdo produkt/shërbim shtesë i ofruar nga banka së bashku me kontratën e kredisë dhe që nuk është | Informacion mbi produktet/shërbimet shtesë të ofruara nga banka:<br>Llogari rrjedhëse / page e lidhur me kredin |

| | |
|---|---|
| përmendur në seksionet e mësipërme. | |
| Informimi në rast refuzimi të kredisë | Banka informon klientin menjëherë dhe pa komisione nëse aplikimi i tij për kredi është refuzuar duke i vënë në dispozicion dhe arsyet mbi te cilat është bazuar ky refuzim. |
| E drejta e pajisjes me kopjen e projektkontratës së kredisë<br><br>*Konsumatori ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin.* | Konsumatori ka të drejtën për t'u pajisur, me kërkesën e tij dhe pa pagesë, me një kopje të projektkontratës së kredisë. Kjo e drejtë nuk do të zbatohet nëse banka, në kohën e kërkesës, nuk është e gatshme të vazhdojë me nënshkrimin e kontratës së kredisë me konsumatorin. |
| Mënyra e njoftimit, si dhe mënyra e marrjes së pëlqimit të konsumatorit, në rast ndryshimesh të kushteve, të cilat sjellin pasoja në bazë të kontratës | Cdo kusht i ndryshuar ne kontrate behet me amendim kontrate dhe me nenshkrimin e ketij dokumenti nga te dy palet si Banka dhe klienti. Asnje ndryshim ne kontrate nuk behet pa pranine e klientit. |
| Skema e brendshme e ankimimit të konsumatorit kundrejt bankës | Nje ankimim mund te depozitohet përmes kanaleve të mëposhtëm:<br><br>• Duke plotësuar formën e dedikuar në faqen zyrtare të RBAL<br>• Në aplikacionin mobile Raiffeisen ON<br>• Pranë degëve të Bankës Raiffeisen<br>• Duke telefonuar Shërbimin e Klientit në +355 4 2381 381<br>• Duke shkruajtur në adresën e e-mail: ankesa.online@raiffeisen.al |
| Periudha kohore gjatë së cilës Banka ka detyrime që rrjedhin nga informacioni parakontraktor | Ky informacion është i vlefshëm për 7 ditë kalendarike: prej datës ___/___/______ deri në datën ___/___/______ |

Konsumatori
*(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)*

(emër mbiemër, nënshkrimi)

Date/Muaj/Vit: ___/___/______

## ANEKS

**Njoftim mbi përpunimin e të dhënave nga Autoriteti i Konkurrencës, në rast monitorimi, hetimi paraprak apo hetimi të thelluar ndaj Bankës.**

-Duke pasur në konsideratë se hetimet e Autoritetit të Konkurrencës përgjithësisht nuk kanë në fokusin e tyre aksesimin dhe përpunimin e të dhënave personale të klientëve të subjekteve-objekt inspektimi për të kryer inspektime dhe për të konkluduar mbi funksionimin/zbatimin e drejtë të rregullave të konkurrencës nga aktorët e tregut.

-Duke pasur parasysh se Banka nga ana e saj si entitet kontrollues,vepron në përputhje me Ligjin nr.124/2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", si dhe Udhëzimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, merr masa që infomacioni, i cili përfshin të dhëna personale dhe sensitive të klientëve, të vihet në dispozicion Autoritetit të Konkurrencës në mënyrë statistikore dhe të enkriptuar, për të ruajtur privatësinë e klientëve si subjekte të të dhënave personale.

-Në qoftë se, për përmbushjen e qëllimit të një inspektimi specifk, Autoriteti argumenton se e ka të pamundur realizimin e përmbushjes së qëllimit të inspektimit pa përpunuar të dhëna personale të klientëve apo/dhe të dhëna sensitive të klientëve, ky përpunim do të mundësohet vetëm bazuar në autorizimin paraprak të klientit, në përmbushje të nenit 7, pika 1 gërma a), nenit 8 pikat 1,2,3,4,5 dhe nenit 9 pika 2 germa a) e Ligjit nr 124/2024".

## HEMBULL ILUSTRUES PËR RREZIKUN E KURSIT TË KËMBIMIT PËR KREDINË NË MONEDHË TË NDRYSHME NGA AJO E GJENERIMIT TË TË ARDHURAVE

Tekst sqarues për konsumatorin

Kredidhënia në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjenerohen të ardhurat, për konsumatorin që nuk është i mbrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, shoqërohet me rreziqe të konsiderueshme. Për shembull, një nënçmim i fortë i kursit të këmbimit do të shkaktonte vështirësi në aftësinë e konsumatorit për të shlyer kredinë. Këto vështirësi mund të çonin në dështimin e konsumatorit për të shlyer kredinë, në kthimin e kredisë në statusin "me probleme" dhe mund të përfundonin në fillimin e procedurave për ekzekutimin e detyrimit nga ana e bankës.

Ky aneks përmban një shembull me natyrë ilustruese dhe informuese, dhe nuk përfaqëson një pritshmëri apo angazhim ligjor nga kredidhënësi apo kredimarrësi.

Konsumatori që aplikon për kredi në një monedhë të ndryshme nga ajo në të cilën gjeneron të ardhurat, nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti vërteton se: 1) e ka marrë këtë dokument nga banka përpara lidhjes së kontratës së kredisë; 2) e ka kuptuar shembullin dhe efektet e mundshme nga lëvizjet në kursin e këmbimit; 3) është i bindur që mund të përballojë rreziqet që shoqërojnë kredinë.

Dokumenti i nënshkruar është pjesë e analizës që bën banka për dhënien e kredisë te konsumatori, por dokumenti i nënshkruar nuk e detyron bankën për dhënien e kredisë dhe as nuk e redukton përgjegjësinë që ka banka për të kryer analizën e saj të plotë për qëndrueshmërinë financiare të aplikuesit për kredi.

Të dhëna për kredinë në monedhë të ndryshme nga monedha e gjenerimit të të ardhurave

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Kredimarrësi: | Emër_ | Mbiemër_ | | |

Kredidhënësi: Banka Raiffeisen

Lloji i kredisë (hipotekore/konsumatore): Hipotekore

Kohëzgjatja e kredisë: 120 muaj

Vlera e kredisë: 25,000

| |
|---|
| Njësia monetare: EUR<br><br>Kursi i këmbimit, në datën e vlerësimit të planit ilustrues: 130.2<br><br>Kundërvlera e kredisë në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat: 3,255,000 LEK<br><br>Norma efektive e interesit: 4.33%<br><br>Indeksi orientues/norma referencë: 0<br><br>Marzhi: 3.50%<br><br>Tëardhurat mujore (bruto/neto) të huamarrësit në monedhën në të cilën gjeneron të ardhurat (mesatare e 3 viteve të fundit): 70,000 LEK |

Tabelë 1: Kësti i kredisë dhe raporti i vlerës së këstit të kredisë ndaj të ardhurave (në %), sipas skenarëve të rrezikut të ndryshimit të kursit të këmbimit.

| **Skenari** | **Vlera e këstit e shprehur në monedhën e kredisë** | **Kundërvlera e këstit në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat** | **Të ardhurat (mesatare mujore të 3 viteve të fundit) në monedhën në të cilën ato gjenerohen** | **Raporti i vlerës së këstit ndaj të ardhurave** |
|---|---|---|---|---|
| | (a) | (b) | (c) | (d) = (b)/(c) |
| Kursi i këmbimit nuk ndryshon | 257.1 | 33,474.84 | 70,000 | 47.80% |
| Nënçmim i kursit të këmbimit me 5% | 257.1 | 35,148.59 | 70,000 | 50.2% |
| Nënçmim i kursit të këmbimit me 20% | 257.1 | 40169.81 | 70,000 | 57.4% |

**Shënime**

- Në kolonën (a) banka paraqet vlerën e këstit, sipas planit të amortizimit të kredisë, në monedhën në të cilën është marrë kredia.
- Kolona (b) paraqet informacion mbi vlerën e këstit sipas planit të amortizimit të kredisë, të konvertuar në monedhën në të cilën konsumatori gjeneron të ardhurat, në rastet kur kursi i këmbimit nuk ndryshon (kursi në këtë rast është i njëjtë me kursin e këmbimit të datës kur i paraqitet ky shembull ilustrues konsumatorit) dhe në rastet kur kursi i këmbimit nënçmohet me 5% ose 20%.
- Kolona (c) paraqet informacion mbi të ardhurat mujore të 3 viteve të fundit të deklaruara nga konsumatori, të shprehura në monedhën në të cilën këto të ardhura gjenerohen.
- Kolona (d) paraqet raportin e këstit (i shprehur në monedhën në të cilën gjenerohen të ardhurat) me të ardhurat e konsumatorit (mesatarja mujore e tre viteve të fundit).

Konsumatori

*(Konfirmon marrjen e informacionit parakontraktor)*

(emër mbiemër, nënshkrimi)

Date/Muaj/Vit: ___/___/______